



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2019
Nr. ref.: RK 1346/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 59/18

Parashtrues

Strahinja Spasić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme
AA-UŽ. nr. 58/2017, të 1 dhjetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesën e dorëzoi Strahinja Spasić nga Klokoti (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, AA-UŽ. nr. 58/2017, të 1 dhjetorit 2017, në lidhje me Vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejme: PZAP), ZL. Anr. 1127/2017, të 8 dhjetorit 2017 dhe Vendimin e Komisionit Qendror Zgjedhor (në tekstin e mëtejme: KQZ), nr. 2585-2017, të 14 dhjetorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 prill 2018, parashtruesi nëpërmjet postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 18 prill 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
8. Më 30 prill 2018, Gjykata informoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës iu dorëzua PZAP-it, Gjykatës Supreme dhe KQZ-së, ku ju dha mundësia për të paraqitur komentet e tyre për pretendimet e ngritura në kërkesën nr. KI59/18.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 18 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë në të cilat më detajisht precizoi kërkesën e tij.
11. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
12. Më 22 gusht 2018, Kryetarja nxori Vendimin për caktimin e gjyqtarës Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese në vend të gjyqtarës Snezhana Botusharova.
13. Më 1 shkurt 2019, Gjykata njoftoi subjektin politik Lista Serbe (në tekstin e mëtejshëm: Lista Serbe) për regjistrimin e kërkesës. Gjykata u dërgoi një kopje të kërkesës dhe kërkoi nga ata që brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga data e pranimit të këtij njoftimi të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën. Lista Serbe nuk dorëzoi komente në lidhje me këtë kërkesë.
14. Më 5 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci.
15. Më 19 shkurt 2019, gjyqtari Bajram Ljatifi kishte kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës që të përjashtohet nga shqyrtimi i kërkesës nr. KI59/18, sepse më herët kishte qenë pjesë e vendimmarrjes për të njëjtën kërkesë përkitazi me procedurat e zhvilluara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm: KQZ).
16. Më 25 shkurt 2019, Kryetarja, në pajtim me nenin 18.1 (1.3) të Ligjit dhe me rregullin (9) të Rregullores së punës, nxori vendim nëpërmjet të cilit u aprovua kërkesa për përjashtim nga procesi i shqyrtimit dhe i vendimmarrjes lidhur me rastin KI59/18.
17. Më 27 mars 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 22 tetor 2017, në Republikën e Kosovës u mbajtën zgjedhjet për organet vetëqeverisëse lokale. Parashtruesi i kërkesës ishte kandidat i Listës Serbe për Kryetarin e Komunës së Klllokotit.
19. Në raundin e parë të zgjedhjeve për organet vetëqeverisëse lokale, asnjëri prej kandidatëve për Kryetarin e Komunës së Klllokotit nuk ka fituar më shumë se 50% plus 1 (një) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë, siç është përcaktuar në nenin 9.5 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (nr. 03/L-072).
20. Më 19 nëntor 2017, u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve për Kryetarin e Komunës së Klllokotit, ku kandidatë ishin parashtruesi i kërkesës, kandidat i Listës Serbe dhe Božidar Dejanović, kandidat i Iniciativës Qytetare Klllokot-Vërbovc.

21. Më 24 nëntor 2017, parashtuesi i kërkesës paraqiti ankesë [nr.1112] në PZAP, duke kërkuar që të anulohet raundi i dytë i zgjedhjeve lokale për Kryetarin e Komunës së Klllokotit, i mbajtur më 19 nëntor 2017, duke pretenduar se ka pasur parregullsi në rinumërimin e votave të pranuar përmes postës.
22. Më 26 nëntor 2017, Lista Serbe e njoftoi PZAP-in që po tërhiqet nga procedura ankimore, ndërsa parashtuesi i kërkesës mbeti pranë ankesës së tij.
23. Më 27 nëntor 2017, PZAP-i [me Vendimin ZL. A. nr. 1112/2017] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtuesit të kërkesës. PZAP-i vlerësoi se parashtuesi i kërkesës nuk arriti që në mënyrë të sigurt dhe bindëse t'i vërtetojë pretendimet nga ankesa në lidhje me parregullsitë në rinumërimin e votave të dërguara përmes postës.
24. Pjesa relevante e vendimit të lartcekur të PZAP-it, përcakton: *"Nga hetimet të cilat i ka kryer ekipi hetues i PZAP-it, në kutinë e votimit BM 137/001, është konstatuar se në kuti gjendeshin 19 pliko të hapura. Këto pliko kanë qenë të tri llojeve të ndryshme, prej të cilave 11 të tipit të njëjtë, 5 të një tipi tjetër të njëjtë si dhe 3 të tipit tjetër të njëjtë. Në kuti ishin 19 fletëvotime, dhe të gjitha fletëvotimet ishin të shënuara me laps kimik dhe me shenjën (✓), dhe nuk ishin të kopjuar, të shënuar për Božidar Dejanović-in, kandidatin e subjektit politik IQ Klllokot – Vërbovc, derisa kandidati Strahinja Spasić nga radhët e subjektit politik Lista Serbe nuk e kishte asnjë votë".*
25. Parashtuesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartcekur të PZAP-it, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që ankesa të miratohet, ndërsa Vendimi i PZAP-it të anulohet.
26. Më 1 dhjetor 2017, Gjykata Supreme me Aktvendimin AA-UŽ. nr. 58/2017 e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtuesit të kërkesës. Gjykata Supreme vërtetoi se gjendja faktike është vërtetuar drejtë, si dhe që nuk është shkelur ligji në dëm të parashtuesit të kërkesës.
27. Në pjesën relevante të arsyetimit të Aktvendimit të Gjykatës Supreme theksohet: *"PZAP gjatë vendimmarrjes ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet relevante dhe në bazë të kësaj i ka zbatuar dispozitat e ligjit, sidomos kur merret parasysh se në rastin konkret parashtuesi i ankesës nuk arriti t'i vërtetojë pretendimet e veta me prova relevante dhe të bindshme. Deklaratat e dëshmitarëve të bashkangjitura në ankesë, kjo Gjykatë i konsideron jo relevante dhe nuk mund të kenë ndikim në vendimmarrje ndryshe, duke marrë parasysh se deklaratat e tilla mund të jenë të kundërta me vullnetin e votuesve, e që është vërtetuar gjatë kontrollit të fletëvotimeve nga ana e PZAP-it".*
28. Më 7 dhjetor 2017, KQZ-ja, me Vendimin nr. 2470-2017, shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të raundit të dytë të votimit në zgjedhjet lokale për Kryetarin e Komunës së Klllokotit.

29. Parashtruesi i kërkesës kundër Vendimit të KQZ-së [nr. 2470-2017] paraqiti ankesë [nr. 1127] në PZAP, duke pretenduar se ka pasur parregullsi në rinumërimin e votave të pranuar përmes postës.
30. Më 8 dhjetor 2017, PZAP-i me Vendimin ZL. A. nr. 1127/2017, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetim se PZAP-iu përgjigj ndaj këtyre pretendimeve të parashtruesit me Vendimin [ZL. A. nr. 1112/2017] e 27 nëntorit 2017, dhe rrjedhimisht, PZAP-i konkludoi se për këtë çështje tashmë është vendosur (*res judicata*) dhe se kjo ankesë duhet të refuzohet si e palejuar.
31. Më 14 dhjetor 2017, KQZ-ja, me Vendimin nr. 2585-2017, certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të raundit të dytë të votimit në zgjedhjet lokale për Kryetarin e Komunës së Klllokotit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
33. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Me mosrespektimin e rregullave pozitive nga ana e PZAP-it, me presionet që kam pasur nga Zyra për Kosovën dhe Metohinë të tërhiqem nga kandidatura, si dhe me presionet e medias, më është shkelur e drejta kushtetuese sipas nenit 21 (Të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore).”*
34. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *“PZAP, si organi i shkallës së parë, jo vetëm që nuk i ka pranuar pretendimet ankimore të ankuesit, por ankesën e ka shpallur si të palejueshme dhe po ashtu nuk është lejuar as ankesa në organin e shkallës së dytë, me çka është shkelur neni 32 i Kushtetutës së Kosovës (E drejta për mjete juridike).”*
35. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 45 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Duke manipuluar dhe abuzuar me 19 votat e marra përmes postës nga lista e veçantë e votuesve për votim jashtë Kosovës nga Zyra për Kosovë e Metohi në Beograd, mua po me merret një fitore zgjedhore dhe fiton me vota të manipuluar kandidati sipas vullnetit të Zyrës në Beograd”.*
36. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *“PZAP-ja me procedurë nuk e ka respektuar Ligjin për Zgjedhjet Lokale dhe të Përgjithshme, as rregullat zgjedhore në të cilat në mënyrë të qartë është rregulluar mënyra e raportimit dhe votimit të votuesve nga lista e veçantë zgjedhore e Kosovës, por në të njëjtën ditë kur është dorëzuar ankesa e ankuesit nxori Vendimin e pakuptuar nr. ZL. Anr. 1127/2017, të 08.12.2017, si të palejuar, pa të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës si organ i shkallës së dytë”.*

37. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

“Që të anulohen fletëvotimet e arritura nëpërmes të postës nga lista e posaçme për votim jashtë Kosovës.

-Që të priset vendimi i KQZ-së nr. 2470/2017 të dt. 07.12.2017, mbi publikimin e rezultateve përfundimtare, vendimi i PZAP-it ZL. A. nr. 1127/2017 të dt. 08.12.2017 dhe vendimi i KQZ-së nr. 2585/2017 të dt. 14.12.2017 mbi konfirmimin e rezultatit përfundimtar të raundit të dytë për Komunën e Klokotit.

-Që të ngarkojë PAZP-in dhe KQZ-në ta ndryshojnë vendimin mbi konfirmimin e rezultateve përfundimtare në favor të ankuesit”.

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji nr. 003/L-073

Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

i 5 qershorit 2008

[...]

Kreu XX

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

[...]

Neni 118

Vendimet

118.1 KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

118.2 KZAP-i ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. KZAP-i u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej dy (2) ditëve nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera KZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve të punës.

118.3 Vendimet e KZAP-it publikohen në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e KZAP-it.

118.4 Mund të apelohej vendimi i KZAP-it, sikurse që KZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar apo edhe për shkak të vullnetit të mirë të treguar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës pranohet në rast se gjëbja e përfshirë është më e lartë sesa 5,000 euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme u jep përparësi këtyre apeleve.

118.5 Vendimi i KZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar sipas këtij ligji ose Kushtetutës parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe gjykata më e lartë përcakton ndryshe.

Rregulli nr. 02/2015

Rregullat dhe procedurat Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa i 4 dhjetorit 2015

[...]

Neni 6 Shqyrtimi i ankesave

6.1 Çdo ankesë e pranuar në PZAP do të regjistrohet me numër të protokollit dhe do të jetë pjesë e lëndës dhe e regjistrit të përhershëm të PZAP-it.

6.2 Deri në marrjen e vendimit kryesor, për shqyrtimin e ankesës palët mund ta tërheqin ankesën e parashtruar.

6.3 Ankesa e cila nuk i plotëson kriteret e parapara sipas nenit 5.7 të këtyre rregullave, i kthehet palës ankuese në përmirësim dhe plotësim në afat prej njëzetekatër (24) orëve. Do të konsiderohet si e tërhequr ankesa po që se nuk i kthehet PZAP-it brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, ankesa do të hidhet poshtë.

6.4 Ankesat të cilat janë të palejuara dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim.

6.5 PZAP-i, me vendim aprovon-refuzon ankesat në përputhje me dispozitat ligjore.

6.6 Në rastet kur PZAP-i konsideron se ankesa është e rregullt, pala ndaj së cilës është parashtruar ankesa do të njoftohet dhe do t'i sugjerohet se ka të drejtë të përgjigjet në ankesë në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i pranimi të ankesës së bashku me provat.

6.7 Pala e cila është njoftuar nga PZAP-i se është bërë ankesë ndaj saj, e njëjta mund të ndërmarrë masa përmirësuese brenda afatit të caktuar nga PZAP-i prej njëzetekatër (24) orëve nga pranimi i urdhrin për përmirësim.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafëve 1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113

„(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

„(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

40. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.“

41. Sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata vërteton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila e konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Vendimin e PZAP-it, ZL. A. nr. 1127/2017, parashtruesi i kërkesës gjithashtu qartësoi saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon të janë shkelur në pajtim me kriteret nga neni 48 të Ligjit.

42. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...].

43. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

“[...]”

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit [...].

44. Në fillim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, më 1 dhjetor 2017, nxori Aktvendimin përfundimtar AA. UŽ. nr. 58/2017 lidhur me ankesën [1112], të cilën parashtruesi i kërkesës e inicioi para PZAP-it.

45. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesi i kërkesës më pas paraqiti përsëri ankesën [1127] në PZAP, me pretendimet identike në lidhje me Vendimin [nr. 2470-2017] e KQZ-së, të 7 dhjetorit 2017. PZAP-i, pas shqyrtimit të kësaj ankese të parashtruesit të kërkesës, nxori Vendimin ZL. A. nr. 1127/2017, të 8 dhjetorit 2017, në të cilin theksoi se këto pretendime të parashtruesit i kishte

shqyrtuar dhe arsyetuar në vendimin e mëparshëm, dhe rrjedhimisht për këtë çështje tashmë është vendosur dhe për këtë arsye kjo ankesë e parashtruesit është e palejuar.

46. Pas kësaj, KQZ-ja, me Vendimin nr. 2585-2017, të 14 dhjetorit, certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale të vitit 2017 për Kryetarin e Komunës së Klllokotit.
47. Për më tepër, Gjykata rikujton se ankesën e parashtruesit PZAP-ja e ka refuzuar si të palejuar, sepse nuk ishte dorëzuar në pajtim me nenin 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, i cili përcakton: "*KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*".
48. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës tentoi t'i shfrytëzojë mjetet juridike për të cilat kishte njohuri, ose është dashur të ketë njohuri, se ato mjete juridike në këtë rast nuk janë të parapara me ligj dhe rrjedhimisht nuk kanë qenë të lejueshme.
49. Gjykata rithekson se "*mund të merren parasysht vetëm ato mjete të cilat janë efektive, pasi që parashtruesit nuk mund të zgjasin afatin kohor strikt të cilin e imponon Konventa, duke u përpjekur të ushtrojnë kërkesa të papërshtatshme apo të dërguara gabimisht në organet apo institucionet të cilat nuk kanë mundësi për të ofruar mjetin juridik efektiv për ankesën e dhënë*". Shih: *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), rasti *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 14881/04, Vendim për pranueshmëri i 5 janarit 2006.
50. Gjykata rikujton se afati 4 (katër) mujor fillon të ecë nga data e dorëzimit të vendimit përfundimtar. Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Paul dhe Audrey Edwards kundër MB*, kërkesa nr. 46477/99, Aktgjykim i 14 marsit 2002.
51. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se periudha 4 (katër) mujore fillon të ecë nga data e dorëzimit të vendimit përfundimtar i cili është rezultat i shterjes së mjeteve juridike të cilat janë adekuate dhe efektive në lidhje me rastin i cili është objekt i ankesës. Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Norkin kundër Rusisë*, kërkesa nr. 20156/11, Vendim për pranueshmëri, i 5 shkurtit 2013; shih, gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI201/13, parashtruese e kërkesës: *Sofa Gjonbalaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 2 prillit 2014, paragrafi 32.
52. Gjykata rikujton se "*në qoftë se asnjë mjet juridik nuk është i disponueshëm apo nëse vlerësohet se ato janë joefektive*", afati kohor 4 (katër) mujor i paraparë me nenin 49 të Ligjit në parim ecë nga data e dorëzimit të aktit i cili është objekt i ankesës. Shih: rastin e GJEDNJ-së, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë*, kërkesa nr. 38587/97, vendim i 29 janarit 2002.
53. Gjykata, më tej, rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike, duke siguruar se rastet që ngrenë çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda një afati të arsyeshëm dhe se vendimet e mëparshme nuk

janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin e GJEDNJ-së, *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 23274/04, Vendim për pranueshmëri, i 25 gushtit 2005).

54. Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konsideron se vendimi përfundimtar në kërkesën e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, AA. UŽ. nr. 58/2017, i 1 dhjetorit 2017. Prandaj, afati kohor fillon të ecë prej 1 dhjetorit 2017, që është data kur aktvendimi i lartpërmendur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij më 12 prill 2018. Periudha 4(katër) mujore për parashtrimin e kërkesës ka skaduar më 1 prill 2018.
55. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
56. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe të rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 27 mars 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi